



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:071526

Datë: 29.08.2024

Numri i dokumentit: 06100208

KF.nr.503/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me zyrtaren ligjore Vesa Statovci, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Arena Trade” SH.P.K, me seli në Fushë Kosovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti rivlerësim i mallit, vlera e kontestit 18,779.94 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të mbajtur në prani në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit avokat Senat Elshani, nga Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata”, dhe përfaqësueses së autorizuar të palës së paditur Krenare Shala, me datë 01.08.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZHET kërkesëpadia e paditësit “Arena Trade” SH.P.K, me seli në Fushë Kosovë, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI Aktvendimi nr.01.3.2.2/470; 548-18; 889-18; 265-2018 i datës 17.03.2021, i Doganës së Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Paditësi “Arena Trade” SH.P.K, me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 16.04.2021, ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ kundër vendimit nr.01.3.2.2/470; 548-18; 889-18; 265-2018 i datës 17.03.2021, të të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, për shkak se pala e paditur e ka nxjerr përsëri aktin e vetë të mëhershëm më parë të anuluar me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës kompetente, ndërsa me parashtrësën e datës 25.07.2024 ka bërë precizimin e kërkesëpadisë duke kërkuar kthimin e mjeteve të paguara më tepër në emër të taksave doganore

importuese në shumën prej 18,779.94 €, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e importit me datë 24.08.2018, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor - kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka deklaruar se: Vendimin kontestues të të paditurës e kundërshtojmë në tërësi pasi vlerësojmë se i njëjti eshët nxjerrë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës, në konstatim të gabuar të gjendjes faktike, në zbatim të gabuar të së drejtës materiale si dhe në kundërshtim me vërejtjet e dhëna nga gjykata përmes Aktgjykimeve A.nr.1355/18, A.nr.368/18 dhe A.nr.2750/18. Po ashtu sqarojmë faktin se në rastin konkret, e paditura e konteston vlerën e mallit lëndor, ndërsa lidhur me vlerën e mallit lëndor, sqarojmë se ka një harmonizim të plotë sa i përket çmimit për kilogram të deklaruar në pro faturë, në kontratat e shitblerjes si dhe në faturat e mallit lëndor. Ndërsa, lidhur me sasinë e mallit lëndor, në ato raste kur Dogana e Kosovës ka dyshuar lidhur me sasinë e mallit, ka bërë kontrollimin dhe verifikimin e sasisë, origjinës, llojit të mallit, dhe çdo herë ka konstatuar se nuk është hasur ndonjë parregullsi dhe lidhur me këtë i paraqesim gjykatës disa konfirmime të lëshuara nga e paditura, konfirmime këto të nxjerra nga sistemi ASYCUDA i doganës. Po ashtu është me rëndësi të theksojmë faktin se e paditura nuk ka paraqitur ndonjë provë për të dëshmuar që paditësi të ketë paguar më shumë se sa vlera e transaksioneve bankare të mallit lëndor. Andaj, vlerësojmë se një arsyetim i tillë i të paditurës nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm për ta rivlerësuar mallin pa bërë vlefshmërinë e dokumentacionit përcjellës se mallit lëndor. Andaj, i propozojmë gjykatës që ta aprovojë në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit ashtu siç është precizuar në këtë seancë. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 21.10.2021 e konteston në tërësi si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se aktvendimi i atakuar është marr komfor të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i kontestuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme relevante juridike. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor - kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar e të paditurit ka deklaruar se: Dogana sqaron se ka të krijuar bazën e vet dhe mekanizmat e sektorit të vlerës, të cilët në vazhdimësi përcjellin çmimet e bursave ndërkombëtare, dhe në rastin konkret është vlerësuar se disa nga mallrat kontestuese kanë vlerë më të ulët për t'u konsideruar si vlerë transaksioni, pasi çmimet e bursave ndërkombëtare janë çmime të cilat kontraktohen në sasi të mëdha dhe mund të konsiderohet burim i parë i çmimit, andaj, një referencë e tillë vlerëson se është pragu minimal ngase tani është

e ditur se mallrat shiten dhe rishiten dhe pas çdo shitje kanë kosto më të lartë, andaj, kjo tregon shumë në raport me rivlerësimin e mallit në rastin konkret. Mallrat kontestuese nuk janë mallra të korrjeve të mëhershme ashtu siç janë trajtuar në rastet tjera, mirëpo janë mallra të cilat rivlerësohen nga çmimet e bursave ndërkombëtare. Bazuar në thëniet e cekura si më lart si dhe arsyetimin e vendimit kontestues, i propozoj gjykatës që të marrë aktgjykim me të cilin do të refuzonte në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ta lë në fuqi vendimin kontestues. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 01.08.2024 ka administruar provat dhe atë: Aktvendimi 470, 548-18, 889-18, 210, 265-2018, i datës 17.03.2021; Aktvendimi 210, 265 i datës 11.05.2018; Aktvendimi 889, i datës 01.02.2018; Aktvendimi 470, 548 i datës 13.09.2018; Proceset mbi përcaktimin e vlerës së mallrave; Aktvendimi 131/30.01.2020, me numër 6695/24.02.2020; DUD-at 21757, 19116, 18294, 15149, 7972, 8644, 6988, 7384, 7631, 7969, 8490, 32060, 30284, 70517, 70748, 31329, 72063, 32617, 29733, 30238, 591, 602, 1497, 1617, 1982, 2508 dhe 13681; Faturat; Pro faturat; Urdhër pagesat bankare ndërkombëtare të datës 31.07.2018, 30.07.2018, 08.08.2018, 27.06.2018, 12.04.2018, 25.04.2018, 04.04.2018, 10.04.2018, 10.04.2018, 16.04.2018, 20.04.2018, 18.12.2017, 30.11.2017, 05.12.2017, 11.12.2017, 13.12.2017, 12.12.2017, 21.12.2017, 27.11.2017, 30.11.2017; Deklaratat T1; Deklaratat EX1; Packing list; CMR; DV1; Kontratat e shitblerjes; Përgjigja në padi; Dosja e vlerës; Të dhënat nga ASYCUDA për DUD-at 70517, 30238, 32068, 70517 dhe 31329 dhe Parashtresat e të paditurës lidhur me vlerën e kontestit të datës 14.01.2021.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar - administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar - administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ, deklarimeve në ankesë, shkresave të lëndës, aktvendimit kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestues fakti se subjekti në procedurë këtu paditësi “Arena Trade” ShPK me seli në Fushë Kosovë, përmes DUD-ave R-29733/02.12.2017, R-

30284/07.12.2017, R-30238/07.12.2017, R-70517/13.12.2017, R-70748/14.12.2017, R-31329/16.12.2017, R-72063/19.12.2017, R-32060/22.12.2017, R-32617/26.12.2017 të ZBD Prishtinë, R-15149/10.07.2018, R-18294/14.08.2018, R-19116/24.08.2018 të ZBD Interevropa, R-21757/13.08.2018 të ZD Hani i Elezit, R-6988/06.04.2018, R-7384/12.04.2018, R-7631/14.04.2018, R-7972/19.04.2018, R-7969/19.04.2018, R-8490/25.04.2018, R-8644/27.04.2018 të ZBD Interevropa, ka deklaruar për zhdoganim mallin lëndor sipas dokumentacionit përcjellës të mallit. Nuk ishte kontestues as fakti tjetër se e paditura e ka kontestuar vlerën e deklaruar të mallit nga këtu paditësi, e ku si rezultat i kësaj përmes proceseve mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, ka caktuar bazë të re doganore për këtë mall, duke u bazuar në metodën e (6) gjashtë të vlerësimit nga neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109, përkatësisht në bazë të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës, respektivisht dosjes së vlerave si çmime referuese çmimet e bursës. Po ashtu, nuk është kontestues as fakti se paditësi ka ushtruar ankesë në Doganën e Kosovës e për të cilën ankesë e paditura me datë 17.03.2021, ka sjell aktvendimin nr.01.3.2.2/470; 548-18; 889-18; 265-2018 i datës 17.03.2021, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, e kundër të cilit aktvendim paditësi me padinë e datës 16.04.2021, ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve-Dogana e Kosovës e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë, këtu paditësit për rishqyrtimin e Deklaratave Unike Doganore të lartcekura, dhe ka lënë në fuqi të njëjtat. Me arsyetim se Zyra e Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor si në Deklaratat Unike Doganore, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlera reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël sesa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport, përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDA-së. Tutje ka theksuar se Dogana e Kosovës me qëllim të përforcimit të bindjes së Doganës në kuptim të rivlerësimit dhe marrjes së një vendimi të drejtë, duke i marrë parasysh edhe pretendimet e subjektit ankimor, ka hulumtuar dhe analizuar në sistemin COGNOS dhe ASYCUDA, dhe ka konstatuar se kemi importe tjera nga importues të tjerë për mallin e njëjtë dhe të ngjashëm të zhdoganuar në periudhë të afërt kohore me mallin lëndor kontestues, me origjinë të njëjtë, me kod tarifor të njëjtë, me emërtim të mallit të njëjtë, pra që kanë karakteristikat e njëjta të llojit të mallit dhe që vlera e këtij malli është më e lartë se sa vlera e mallit kontestues dhe vlera nga bursa. Andaj, është ardhur në përfundim se nuk qëndron pretendimi i subjektit ankimor se vlera e mallit kontestues është

vlerë reale, pasi që kemi zhdoganime me mall të njëjtë, por me vlerë më të lartë të transaksionit. Ndërsa lidhur me vërejtjet e gjykatës, ka theksuar se Dogana e Kosovës e sheh të vështirë të konstatoj pavlefshmërinë e dokumentacionit përcjellës në kuptim të vërtetësisë së tij, ngase ajo do të duhej të ishte rezultat i verifikimeve ndërkombëtare, për çka Dogana vlerëson se për nga vëllimi i lëndëve e ka të vështirë të ndërmerr veprime administrative të kësaj natyre, mirëpo ajo çfarë mund të konsiderohet fakt se si Dogana vjen deri tek një rivlerësim i mallit, Dogana sqaron se ka krijuar data bazën e vet dhe mekanizmat e Sektorit të Vlerës së mallit të cilat në vazhdimësi përcjellin çmimet e bursave, ngase malli është mall çmimet e të cilit i referohen bursave ndërkombëtare, dhe në rastin konkret Dogana ka vlerësuar se disa nga mallrat e subjektit në procedurë ato kontestuese kanë çmime më të ulëta për tu konsideruar si vlerë transaksionale, sepse Dogana vlerëson se çmimet e bursave ndërkombëtare janë çmime të cilat kontrahohen në sasi të mëdha, pra mund të konsiderohet burim i parë i çmimit. Prandaj, një referencë e tillë Dogana vlerëson se është pragu minimal, ngase tani është e ditur se mallrat shiten e stërshiten dhe gjithmonë kanë kosto më të lartë. Tutje ka theksuar se Dogana sqaron se mallrat e subjektit në procedurë nuk janë mallra të korrjeve të mëhershme ashtu siç i ka trajtuar Dogana në raste të tjera, mirëpo janë mallra të cilat rivlerësohen nga çmimet e bursës ndërkombëtare. Për këtë arsye Dogana e Kosovës pas rishqyrtimit të kërkesës me shkresat e bashkangjitura në lëndë dhe vërejtjeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka konstatuar se malli lëndor kontestues nuk mund të vlerësohet sipas nenit 33, respektivisht sipas vlerës së transaksionit, duke vepruar si në dispozitiv të aktvendimit të kontestuar.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e aktvendimit të kontestuar të të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me aktvendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi janë kundërthënëse dhe si të tilla nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje tregtare - administrative.

Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, ne vështrim të nenit 44, parag. 1, të LKA-së, duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare për nulitetin e aktit administrativ, kjo sipas parag. 2, të këtij neni. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor kryesor sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata vlerëson si të pa bazuar pretendimin e paditësit se i njëjti konform nenit 33 të KDA-së gjatë zhdoganimit të mallit lëndor ka paraqitur gjithë dokumentacionin e nevojshëm, kjo për faktin se në rastin konkret subjekti në procedurë këtu paditësi nuk ka ofruar dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar për të dëshmuar vlerën reale të paguar për mallin kontestues.

Për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmojë vlerën e transaksionit të cilën i'a ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor. Edhe pse pala paditëse i ka prezantuar Gjykatës provat materiale dhe atë Urdhër pagesat bankare ndërkombëtare të datës 31.07.2018, 30.07.2018, 08.08.2018, 27.06.2018, 12.04.2018, 25.04.2018, 04.04.2018, 10.04.2018, 10.04.2018, 16.04.2018, 20.04.2018, 18.12.2017, 30.11.2017, 05.12.2017, 11.12.2017, 13.12.2017, 12.12.2017, 21.12.2017, 27.11.2017, 30.11.2017, mirëpo gjykata vlerëson së të njëjtat nuk janë të harmonizuara me faturat sa i përket shumës së paguar, si dhe në rastin konkret mungojnë kredi apo debi notat. Pra, si të tilla edhe nuk mund të pranohen dhe nga gjykata vlerësohet sikurse nuk kemi fare transaksione bankare andaj edhe nuk mund të aplikohet neni 33 par. 1 të KDA-së. Prandaj, Gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar drejtë kur me vendimin kontestues ka konfirmuar rivlerësimin e mallit lëndor për Deklaratat Unike Doganore R-29733/02.12.2017, R-30284/07.12.2017, R-30238/07.12.2017, R-70517/13.12.2017, R-70748/14.12.2017, R-31329/16.12.2017, R-72063/19.12.2017, R-32060/22.12.2017, R-32617/26.12.2017 të ZBD Prishtinë, R-15149/10.07.2018, R-18294/14.08.2018, R-19116/24.08.2018 të ZBD Interevropa, R-21757/13.08.2018 të ZD Hani i Elezit, R-6988/06.04.2018, R-7384/12.04.2018, R-7631/14.04.2018, R-7972/19.04.2018, R-7969/19.04.2018, R-8490/25.04.2018, R-8644/27.04.2018 të ZBD Interevropa, duke aplikuar metodën gjashtë të vlerësimit neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, përkatësisht të dhënave të disponueshme.

Gjykata vlerëson se e paditura e ka arsyetuar mjaftueshëm në aktvendimin kontestues edhe kalimin nga njëra metodë e vlerësimit në tjetrën, duke filluar nga metoda e parë dhe në mënyrë kronologjike deri në metodën e gjashtë. Për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmojë vlerën e transaksionit të cilën i'a ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor me të dhëna dhe referenca të sakta të faturave në urdhërpagesat ndërkombëtare. Edhe pse pala paditëse i ka prezantuar Gjykatës provën materiale si urdhërpagesat bankare ndërkombëtare të njëjtat siç u theksua më lartë nuk janë të harmonizuara me faturat për mallin

lëndor kontestues, prandaj edhe Gjykata i pranon konstatimet e cekura në arsyetimin e aktvendimit kontestues se dokumentacioni përcjellës i mallit është provë e pamjaftueshme.

Në vijim pretendimin e paditësit se vendimi kontestues i të paditurës është nxjerrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës, me kontestim të gabuat të gjendjes faktike, me zbatim të gabuar të së drejtës materiale si dhe në kundërshtim me vërejtjet e dhëna nga gjykata përmes aktgjykimeve A.nr.1355/18, A.nr.1355/18, A.nr.368/18 dhe A.nr.2750/18, gjykata e vlerësoj si të pa bazuar, ngase përveç të theksuar në padi si të tillë nuk e ka argumentuar me asnjë provë të vetme materiale këtë pretendim e që sipas nenit 7 Par. 1 dhe 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr.03/L-006 parashihet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Nga këto dispozitat Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj. Tutje edhe sipas nenit 38 par. 2 të LKA-së Gjykata vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve. Pala paditëse duhet të parashtroj faktet në të cilat mbështetet kërkesa e saj. Esenca e parimit të shqyrtimit qëndron në atë se Gjykata do të merr parasysh vetëm ato fakte të cilat janë paraqitur dhe shtjelluar nga palët ndërgjyqëse, dhe tanimë është e qartë se barra kryesore për paraqitjen e fakteve dhe provave në një proces gjyqësor u takon palëve.

Gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar - administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative në vështrim të nenit 43 paragrafi 1 të LKA-së. Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë kontest tregtar administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t’ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e vërtetë e transaksionit e paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave Nr.03/L-109.

Gjykata thekson se në nenin 33 par.1 të KDAK-së është parashikuar se: *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, ndërsa në nenin 34 par.1 të KDAK-së parashihet që “Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33, ajo duhet të përcaktohet sipas renditjes kronologjike të nën-paragrafëve (a), (b), (c) dhe (d) të paragrafit 2,*

duke filluar nga nën-paragrafi i parë (metoda e dytë), që lejon përcaktimin e asaj vlere, me përjashtim të rasteve në të cilat radha e aplikimit të nën-paragrafëve (c) dhe (d) mund të kapërcehet me kërkesën e deklaruesit; Vetëm në rast kur vlera nuk mund të përcaktohet në bazë të një nën-paragrafi të caktuar, lejohet të aplikohen dispozitat e nën-paragrafit që vjen me radhë menjëherë pas tij". Nga këto dispozita ligjore, Gjykata konstaton se e paditura në rastin konkret, ka vepruar në mënyrë të drejtë kur ka rivlerësuar mallin e importuara nga paditësi, duke dhënë arsyetim të mjaftueshëm se përse vlerësimi i mallit nuk mund të bëhet me metodën e parë siç parashihet me ligj, pasi që paditësi rezulton të ketë dorëzuar dokumentacionin jo të harmonizuar, e të kërkuar ligjërisht dhe kështu ka dështuar të provoj edhe vlerën e transaksionit për mallin e kontestuar, si dhe çmimin vërtetë të paguar, siç përcaktohet me nenin 33 par.1 të KDAK-së.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43, parag. 1, dhe nenit 46, parag. 2, të LKA-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.503/22 datë 01.08.2024

Zyrtare Ligjore
Vesa STATOVCI

Gj y q t a r i,
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.